



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 370/1 Prot.

Tiranë, më 17.02.2026

V E N D I M

Nr. 33, Datë 17.02.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 172, datë 30.07.2025, e znj. E.T, kundër Bashkisë Tiranë dhe Njesisë Administrative nr. 3, të Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *“Kam punuar në Njësinë Administrative nr. 3, prej datës 02.05.2018, pa asnjë problem, gëzoja respektin e qytetarëve dhe e doja punën si specialiste, ku kryeja pagesat dhe borderotë për personat me aftësi të kufizuara. Deri në datë 24.12.2024, eprori im ka qenë znj. E.N. Në datë 05.01.2025, znj. E.N largohet dhe si Administratore e Njesisë 3, emërohet znj. E.T, e cila njëkohësisht mban dhe funksionin si kryetare e Gruas së Partisë Socialiste për Njësinë Administrative nr. 3. Që javën e parë, më ka treguar nga ana e saj, një shprehje antipatie kundrejt meje, duke bërë veprime si: dilte nga zyra dhe më bënte me shenjë që të ulja zërin (edhe pse unë detyroheshja ndonjëherë që me kategoritë që punoja të merresha vesh me shkrim, me shenja ose me ngritje të zërit).*

Theksoj se të dyja ish eproret e mia njihen prej vitesh dhe kanë marrëdhënie shoqërore të ngushta. Duke filluar nga muaji Mars, çdo javë, E.T më thërriste në zyrë duke më kërkuar listë me emra, të cilët duhet të votonin për deputeten që ajo dëshironte. Më kërkonte të bëja fushatë në orarin zyrtar

të punës, duke i çuar të gjithë qytetarët që vinin për të kërkuar shërbim në institucion, që t'ia kaloja në zyrën e saj, gjë që nga ana ime nuk u pranua dhe ja kam komunikuar shumë qartë, që nuk mund ta kryejë këtë veprim antiligjor. Por, kjo gjë u krye më së miri nga kolegët e mi dhe unë dola delja e zezë, për të filluar një transferim nga Njësia 3, drejt Lagjes 14, në Astir. Theksoj se institucioni ka kamera nëpër korridore dhe çdo cep të godinës.

Në datë 14.05.2025, në orën 21:31, marr një telefonatë nga ish eprorja ime znj. E.N, dhe në gjysmën e parë të bisedës ajo në konfidencë më kërkoi që ta ndihmoja shqen e saj dhe shefen time aktuale në fushatë, por unë i argumentova se për shumë arsye të mijat nuk mund të punoja këtë vit për zgjedhjet që do të kryheshin. Gjysma e dytë e bisedës agravoj në tone të larta dhe kërcënime se Kryesia e Partisë Socialiste ishin: E.N, E.T, E.M dhe deputetja e zonës, dhe se unë isha vajzë e zgjuar dhe duhet ta kuptoja mirë mesazhin që po më jepej nga Partia. Për këtë bisedë kam foto të bisedës në telefon. Gjithsesi, nuk i mora në konsideratë këto kërcënime, i vlerësova si gjëra që bëhen nga njerëz të vegjël dhe vazhdova normalisht punën.

Në datë 02.06.2025, pasi mbaruan zgjedhjet, mora një telefonatë nga protokolli i Bashkisë Tiranë, se duhet të paraqitesha për të tërhequr një shkresë. Shkova dhe u njoftova me transferimin e përkohshëm në Lagjen 14, Astir. Profili im arsimor është Master i Shkencave në Menaxhim Bankar dhe Bachelor në Financë Bankë, që ishte i ligjshëm me pozicionin tim të punës në Njësinë 3.

Pozicioni i ri është specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve, që bazohet në ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe unë u shndërrova papritur nga një specialiste që programon fonde, gjeneron të ardhura dhe kryen evidenca statistikore, në një punonjëse sociale, me arsyen se ky transferim po kryhej për nevoja të institucionit. Isha punonjësjë më e vjetër e sektorit, pa asnjë shkellje, vërejtje apo masë disiplinore, me një performancë maksimale dhe transferimi u krye, kokë më kokë, me punonjësen A.M, të Lagjes 14. Znj. M u shndërrua nga një specialiste me shkollim Shkenca Politike, në ekonomiste, sikurse unë e kundërta.

Për këtë transferim kam nisur një proces gjyqësor në Gjykatën Administrative, por shpresoj në një zgjidhje më efikase dhe më të shpejtë nga institucioni juaj. Kam dërguar një kërkesë të protokolluar pranë burimeve njerëzore, se nga kush ishte kërkuar ky transferim, por nuk mu dha asnjë shpjegim dhe asnjë dokument në lidhje me të. Vërtet transferimi për mua dhe znj. A.M është i përkohshëm, por ju bëj me dije se znj. A.M është shtatzënë dhe në muajin Tetor, merr lejen e lindjes.

Ligji 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” thekson në një pikë të tijën, se në rastet e marrjes së lejes së lindjes, nuk bëhet më asnjë lëvizje, transferim apo rikthim në vendin e mëparshëm të punës, gjë që tregon se kjo lëvizje është diskriminuese, tendencioze dhe e qëllimshme. Ndihej e diskriminuar, e ulur, e shkelur, edhe në lidhje me arsimin tim, që nuk e mori askush parasysh, se si një ekonomiste nuk mund të bëjë psikologjen”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në pozicionin e punës në Njësinë Administrative nr. 3.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1167/2, datë 06.08.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e ankueses, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Argumentimin Tuaj, Bashkia Tiranë dhe Njësia Administrative nr. 3, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
 - Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi, transferimi, kontratë pune, kopje të Librezës së Punës, etj).
 - Kopje të vlerësimit të punës së ankueses për vitet 2023, 2024 dhe 6-mujori I-rë, viti 2025.
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me transferimin e ankueses. Kopje të dokumentit të kriterit/eve, mbi të cilat është bërë vlerësimi i punonjësve të cilët do transferoheshin dhe tabelës së vlerësimit të tyre.

- Kopje të përshkrimit të punës dhe kriterit të arsimit për pozicionet: Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Njësia Administrative nr. 3 dhe Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Lagje 14.
- Kopje të shkresave/kërkesave të ankueses dhe përgjigjet e dhëna nga Bashkia Tiranë, lidhur me transferimin e znj. E.T.
- Informacion të plotë, nëse ka pasur punonjës të tjerë (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen) që janë transferuar gjatë vitit 2024-2025, në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
- Kopje të plotë të strukturës organizative të Njesisë Administrative nr. 3 dhe të Lagjes 14.
- Kopje të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm të Bashkisë Tiranë.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe parashtrimeve të Bashkisë Tiranë.

Me shkresën nr. 1726/1, datë 13.08.2025, Njësia Administrative nr. 3, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Njësia Administrative nr. 3, nuk ka kompetenca vendimmarrëse për lëvizjen, transferimin apo emërimin e punonjësve në pozicione të ndryshme pune.*

Me email-in zyrtar të datës 28.03.2025, dërguar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Tiranë, është përcjellë Urdhri nr. 6630/1, datë 17.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësit civil gjatë fushatës zgjedhore” dhe Vendimit nr. 6630/2, datë 17.02.2025 “Rregullore e brendshme e grupit të monitorimit në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të udhëzimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ju informojmë se duke filluar nga data 11.04.2025, çdo nëpunës civil dhe punonjës do të duhet të nënshkruajë Aktin e Konstatimit, në momentin e ardhjes në punë dhe në përfundim të orarit zyrtar. Ky udhëzim është zbatuar në mënyrë rigoroze dhe është përcjellë te çdo punonjës. Njësia jonë ka qenë në dijeni të këtij urdhërimi dhe e ka zbatuar atë plotësisht.

Theksojmë se, Njësia Administrative nr. 3 ka vepruar gjithmonë në përputhje me ligjin dhe udhëzimet zyrtare të Bashkisë Tiranë, duke respektuar të drejtat e punonjësve dhe detyrimin për të mos lejuar veprimtari politike gjatë orarit të punës”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 25.08.2025, është njohur me përgjigjen e Njesisë Administrative nr. 3.

Në kundërshtim të përgjigjes të Njesisë Administrative nr. 3, ankuesja me email-in datë 25.08.2025, në mes të tjerash ka informuar se: *“Në shkresën e dërguar nga Njësia 3, citohet vetëm rregullorja në periudhën e fushatës, gjë të cilën, po unë e kam zbatuar sikurse e kam thënë në ankesën time që kam qenë profesionale në punë. Në lidhje me transferimin tim kërkoj të di nga cili epror është*

kërkuar, sepse pranë burimeve njerëzore Bashkia Tiranë, nga znj. J.D më është cituar se ky ishte një vendim midis epurve të Njësive, përkatësisht 3 dhe 14. Unë në asnjë moment nuk kam kërkuar transferim dhe gjithashtu kam kërkuar kopje të kërkesës së specialistes së Lagjes 14, e cila ka kërkuar transferimin, kërkesë e cila nuk mu dha asnjëherë. Në asnjë fjali znj. E.T nuk tregon asnjë arsye të transferimit tim, thjesht ka konfirmuar që unë nuk kam dashur të bëj asnjë veprim antiligjor gjatë orarit zyrtar të punës sikurse e kam theksuar edhe vetë. Kërkoj procedurën që është ndjekur për transferimin tim (dhe kryerjen e qokave të E) pasi vjehrra e znj. A.M është e afërme dhe punon si pastruese në shtëpinë e E.T”.

Me shkresën nr. 27657/1, datë 28.08.2025, Bashkia Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Referuar shkresës me nr. 20050, datë 30.05.2025, njësia përgjegjëse ka vendosur transferimin e përkohshëm të znj. E.T në interes të institucionit të Bashkisë së Tiranës, për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj. Ajo transferohet nga pozicioni: Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Njësia Administrative nr. 3, kategoria e pagës IV-2, në pozicionin: Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Lagje 14, kategoria e pagës IV-2, duke filluar nga data 02.06.2025.

Ky vendim është marrë në zbatim të shkronjës “a” të pikës 1, shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 48 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” (të ndryshuar); shkronjës “a” të pikës 2, 4, 5 të Kreut I “Transferim i Përkohshëm” të VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për Transferimin e Përkohshëm dhe të Përhershëm të Nëpunësve Civil”, dhe nuk ka sjellë asnjë ndryshim në kategorinë e pagës apo të drejtat financiare të ankueses.

Bashkia e Tiranës funksionon si institucion administrativ dhe jopolitik, dhe çdo vendim për transferim apo organizim të stafit merret ekskluzivisht për nevoja funksionale dhe administrative, në përputhje me ligjin, dhe çdo pretendim për diskriminim politik është i pabazuar. Për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, janë zbatuar masa të posaçme sipas udhëzimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke ngritur grupin e punës dhe duke miratuar rregulloren përkatëse. Gjithashtu, me njoftim zyrtar elektronik, i gjithë aparati i Bashkisë përfshirë edhe Njësitë Administrative, është informuar se duke filluar nga data 11.04.2025, çdo nëpunës civil dhe punonjës, duhet të nënshkruajë aktin e konstatimit në hyrje dhe në dalje nga puna, për periudhën e fushatës elektorale. Këto masa janë zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë stafin, duke përjashtuar çdo mundësi të trajtimit preferencial apo diskriminimit politik.

Pretendimi i ankueses se është diskriminuar për shkak të transferimit të përkohshëm në pozicionin Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, me arsyetimin se profili i saj si financiere nuk i përshtatet këtij pozicioni, është i pabazuar ligjërisht.

Nga analiza e përshkrimeve të punës të dy pozicioneve të hartuara sipas Udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017 të DAP-it, rezulton se:

- Për pozicionin Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve, kriteri arsimor është përcaktuar si arsim i lartë në Shkenca Shoqërore, Sociale, Punë Sociale, Ekonomike, Natyrore, Juridike. Ndërkohë, në përshkrimin e punës të pozicionit Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, është parashikuar kriteri arsimor “arsim i lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike”.

Nga krahasimi i të dy përshkrimeve rezulton qartë se arsimi i ankueses përputhet plotësisht me kërkesat e pozicionit ku është transferuar, pa asnjë element që të justifikojë përjashtim.

Analiza e përputhshmërisë së kriterëve tregon se përgatitja akademike e ankueses është e përshtatshme për detyrat e pozicionit të ri. Transferimi është realizuar mbi bazën e vlerësimit objektiv të ngarkesës së punës dhe të nevojës për riorganizim funksional të institucionit, duke përjashtuar çdo qëllim apo trajtim të padrejtë. Ky vendim është i mbështetur plotësisht në ligj dhe përjashton çdo pretendim për diskriminim.

Lidhur me këtë çështje, ju informojmë se znj. E.T ka paraqitur një padi pranë Gjykatës Administrative, me anë të së cilës ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të transferimit dhe kthimin në vendin e saj të mëparshëm të punës. Gjykata Administrative ka refuzuar kërkesën për sigurimin e padisë, duke e vlerësuar atë si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke lënë në fuqi vendimin e Bashkisë së Tiranës.

Ashtu siç është theksuar më sipër, transferimi i përkohshëm i znj. E.T është kryer për nevoja institucionale, duke u bazuar në përputhshmërinë e detyrave të dy pozicioneve. Ky është një transferim i përkohshëm, i cili ndryshon nga transferimi i përhershëm, pasi nuk kërkon proces vlerësimi dhe tabelë pikëzimi, por kryhet vetëm për të përmbushur nevojat funksionale të institucionit.

Nga verifikimet e kryera në protokollin e brendshëm të Bashkisë së Tiranës, dhe të protokollit të jashtëm në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve Publike, rezultoi se nuk kemi të depozituar asnjë ankesë me shkrim nga ana e znj. E.T.

Gjatë viteve 2024-2025 nuk është konstatuar ndonjë rast identik transferimi me atë të ankueses. Transferimet e përkohshme të kryera gjatë kësaj periudhe janë bazuar gjithmonë në nevoja funksionale dhe organizative dhe çdo rast është trajtuar sipas kushteve specifike të institucionit”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 02.09.2025, është njohur me përgjigjen e Bashkisë Tiranë.

Në kundërshtim të përgjigjes të Bashkisë Tiranë, ankuesja me email-in datë 03.09.2025, në mes të tjerash ka informuar se: “Në përgjigjen e kthyer nga Bashkia Tiranë për kriteret e arsimit thuhet: Për pozicionin Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve kriteri arsimor është përcaktuar si “arsim i lartë në Shkenca Shoqërore, Sociale, Punë Sociale, Ekonomike, Natyrore, Juridike”.

Për pozicionin Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, kriteri arsimor është përcaktuar si “arsim i lartë në Shkenca Ekonomike dhe Juridike”, kriter ky që nuk plotësohet nga znj. A.M e cila ka përfunduar arsimin e lartë në Shkenca Politike.

Konstatova se në përgjigjen e kthyer nga Bashkia Tiranë, Njësia përgjegjëse (Njësia Administrative nr. 3) ka vendosur transferimin e përkohshëm për znj. E.T, por nuk egziston asnjë propozim, kërkesë apo shkresë e përcjellë midis institucioneve për këtë veprim administrativ.

Në lidhje me shkresën e dërguar nga Njësia Administrative nr. 3, ku znj. E.T kthen një përgjigje evazive dhe justifikon veten se ka dorëzuar listëprezenca të firmosura sipas rregullores së brendshme të Bashkisë Tiranë, patjetër që këto listëprezenca ishin të rregullta sepse unë kam qenë prezente në punë dhe në krye të detyrës, unë nuk kam pranuar që në ambientet dhe orarin tim të punës të kërkoj votat e qytetarëve dhe ti kaloj në zyrën e E, siç bënte një pjesë e mirë e stafit”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1167/5, datë 27.10.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 04.11.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe ka kërkuar nga subjektet dokumentet si më poshtë:
- Kopje të dosjes personale të punonjësës A.M (vendim emërimi, transferimi, kontratë pune, kopje të Librezës së Punës, arsimi, etj).
- Kopje të vlerësimit të punës të znj. A.M, për periudhën: 6-mujori II-të, viti 2024 dhe 6-mujori I-rë, viti 2025.
- Shpjegime se kush ishin nevojat funksionale dhe administrative të Bashkisë Tiranë për transferimin e znj. E.T.
- Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 04.11.2025, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, znj. E.T dhe përfaqësuesve me autorizim nr. 37737, datë 31.10.2025, të Bashkisë Tiranë, znj. A.Q dhe znj. A.R dhe autorizimit nr. 2423, datë 03.11.2025, të Njesisë Administrative nr. 3, Tiranë, znj. S.A.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit me email dhe shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja në mes të tjerash deklaroi se: “Presionin dhe diskriminimin e kam ndjerë që në muajin prill 2025, pasi nga znj. E.T më është kërkuar që të gjithë qytetarët që vinin dhe

kërkonin shërbimin në zyrën time, unë të bëja fushatë në favor të deputetes që ajo dëshironte. E kam kundërshtuar këtë kërkesë dhe aty filloi kalvari dhe presioni që kam ndjerë.

Ditën e premte datë 31.10.2025 kam qenë me leje dhe jam informuar që ka ardhur vendimi për rikthimin tim në vendin e mëparshëm të punës në Njësinë 3 dhe fakti që kjo ndodhi, një ditë përpara se të zhvillohej kjo seancë dëgjimore, mua më frikëson se pasi të mbydhët ky proces, unë prap do jem e diskriminuar.

Shkaku i bindjes politike e pretendoj se nuk kam pranuar që të bëj fushatë gjatë zgjedhjeve.

Padinë e bërë në gjykatë e kam tërhequr, pasi kërkesa për sigurimin e padisë është rrëzuar dhe seanca është caktuar për në datë 04.02.2026 dhe mua më mbaronte afati i transferimit në datë 02.12.2025”.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësueset e Bashkisë Tiranë në mes të tjerash deklaruan se: “Vendimi i transferimit ishte i përkohshëm dhe i bazuar në legjislacionin e nëpunësit civil dhe është bërë për arsye të një shpërndarje sa më optimale të burimeve njerëzore, sigurimin e një shërbimi sa më të mirë dhe efektiv kundrejt qytetarëve dhe për arsye të përvojës së znj. E.T. Transferime kanë ndodhur, por gjithmonë janë bërë në kuadër të nevojave të institucionit. Në dijeninë tonë nuk ka një kërkesë për transferim të bërë nga znj. A.M. Kriteri i arsimit për të dy punonjëset përshtatet me përskrimet e punës. Ne si Bashki nuk kemi dijeni të funksioneve politike të znj. E.T dhe z. E.M”.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e Njesisë Administrative 3, deklaroi se: “Njësia Administrative nuk ka bërë kërkesë për transferimin e znj. E.T. Ne nuk kishim dijeni përpara shkresës së transferimit. Normalisht që ky transferim nuk ishte i drejtë, por nga njësia jonë, nuk e ka hequr njeri. Znj. E.T ishte një punonjëse shumë e mirë dhe e aftë për punë. Me ardhjen e punonjësës tjetër, ngarkesa në punë u shtua, detyrat u ndanë tek punonjësit dhe pastaj çdo gjë vijoi normalisht”.

Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesja me email-in datë 05.11.2025 dërgoi fotografi dhe informacionin si më poshtë: “Bashkëlidhur do të gjeni fotot e siguruara në rrjetet sociale publike ku tregohet pozicioni i znj. E.T si kryetare e Forumit të Gruas në Njësinë Administrative nr. 3, të bisedës kërcënuese nga znj. E.N, si dhe në dy fotot e fundit (zonja e veshur me xhakëtë bojëqielli është vjehrra e znj. A.M (znj. S.D.Sh), ku provohet se ato kanë njohje dhe miqësi me njëra tjetrën”.

Në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia Tiranë me shkresën nr. 37200/1, datë 17.11.2025, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi si vijon:

“1. Situata aktuale e punonjësës.

Znj. E.T ka qenë subjekt i një transferimi të përkohshëm ndërmjet dy njësive administrative të Bashkisë së Tiranës, por më pas, me aktin zyrtar nr. 20050/1, datë 29.10.2025, ky transferim është ndërprerë dhe znj. E.T është rikthyer në vendin e saj të mëparshëm të punës. Për rrjedhojë, institucioni vlerëson se nuk jemi më në kushtet e shqyrtimit të pretendimeve të ankueses lidhur me transferimin, pasi situata është rikthyer në gjendjen e mëparshme dhe nuk ekzistojnë më efektet administrative të aktit.

2. Lidhur me pikën se cilat ishin nevojat konkrete institucionale që u ndërmor transferimi mes dy punonjëseve, referuar dhe relacionit të Njësise Bashkiake nr. 3, ju sqarojmë si më poshtë:

- Arsyetimi institucional për transferimet e përkohshme.

Në mbështetje të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 3492, datë 24.12.2024, për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Bashkisë Tiranë”, Njësia Bashkiake nr. 3, është pjesë e strukturës së aparatit të Bashkisë Tiranë, dhe si e tillë nuk përbën një strukturë të pavarur, por funksionon në varësi të drejtpërdrejtë të aparatit qendror të Bashkisë. Kjo do të thotë se çdo ndryshim, riorganizim apo transferim i stafit brenda këtyre njësive, është kompetencë e Bashkisë. Duke qenë pjesë e këtij aparati të unifikuar, Njësia Bashkiake nr. 3 është subjekt i të njëjtave politika institucionale të burimeve njerëzore, të cilat kanë si qëllim sigurimin e ekuilibrit ndërmjet njësive, rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve. Në këtë kuadër, çdo vlerësim për transferim të punonjësve realizohet jo në mënyrë të izoluar, por në funksion të nevojave të përgjithshme të aparatit të Bashkisë, duke u mbështetur në analiza të brendshme të ngarkesës së punës, të përbërjes së stafit dhe të dinamikës së shërbimeve. Çdo masë e marrë synon përmirësimin e performancës institucionale në nivel të përgjithshëm.

- Nevojat konkrete institucionale që diktuan transferimin.

Gjatë analizës periodike të kryer nga Njësia e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Njësive Administrative, u konstatua se Njësia Bashkiake nr. 3 kishte një rritje të konsiderueshme të ngarkesës së punës për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

1. Identifikimi dhe trajtimi i rasteve komplekse sociale: Institucioni ka hasur raste të fëmijëve në rrezik dhe familjeve në nevojë për mbrojtje, të cilat kërkojnë vlerësim profesional social, vizita në terren dhe koordinim me sektorë të ndryshëm (arsim, shëndetësi, rend). Kjo nuk mund të menaxhohet vetëm nga profili financiar.
2. Vlerësimi i nivelit të rrezikut dhe hartimi i planeve individuale: Nevoja për të realizuar vlerësime të rrezikut dhe për të hartuar Planin Individual të Mbrojtjes kërkon aftësi sociale dhe njohuri për mbrojtjen e fëmijës, aftësi që tejkalojnë kompetencat financiare.
3. Koordinimi i ndërhyrjeve ndërsektoriale: Ndërhyrjet kërkojnë bashkëpunim me drejtues të njësive, strukturat shëndetësore, arsimore, policore, prokurorisë, gjyqësorit dhe shoqërinë civile. Një punonjëse me profil social është e aftë të menaxhojë këtë rrjet kompleks bashkëpunimi.
4. Monitorimi i progresit dhe raportimi: Vëzhgimi i zhvillimit të fëmijës dhe i zbatimit të masave të mbrojtjes kërkon aftësi të theksuara sociale, komunikim profesional dhe përkujdesje për nevojat e fëmijës, gjë që nuk është brenda profilit kryesor financiar.
5. Pjesëmarrja në proceset gjyqësore: Përfaqësimi i interesit të fëmijës dhe menaxhimi i rasteve në gjykata kërkon aftësi sociale dhe njohuri mbi mbrojtjen e fëmijës, të cilat nuk mbulohen nga një profil financiar.

Rastet e kompleksitetit të lartë, nevoja për vizita në terren, vlerësime sociale, koordinim ndërsektorial, monitorim dhe mbështetje e drejtpërdrejtë ndaj fëmijëve dhe familjeve, kanë treguar qartë që pozicioni i mëparshëm me profil financiar nuk ishte i mjaftueshëm. Kjo ka bërë të domosdoshëm transferimin e punonjësës në një profil social, për të përmbushur me efikasitet detyrat që lidhen me mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët dhe familjet në nevojë.

Pikërisht për këto arsye, Bashkia Tiranë, në cilësinë e organit përgjegjës për administrimin e strukturës dhe organikës, ka ndërmarrë masën e transferimit të përkohshëm të znj. E.T, e cila zotëron arsim dhe eksperiencë në fushën ekonomike-financiare, drejt një pozicioni tjetër ku këto aftësi mund të shfrytëzoheshin në mënyrë më efektive, ndërkohë që një punonjëse me profil social u transferua në vendin e saj për të plotësuar boshllëkun në trajtimin e çështjeve komunitare dhe sociale. Ky ribalancim i burimeve njerëzore është konsideruar nga institucioni si zgjidhje funksionale dhe strategjike, që përmbushte nevojat institucionale.

3. Analiza e profilit profesional dhe përputhshmëria me pozicionin e ri.

Transferimi është kryer duke marrë në konsideratë përgatitjen profesionale dhe eksperiencën e secilës punonjëse, në mënyrë që të sigurohet një përputhje sa më e mirë midis profilit të punonjësit dhe kërkesave të vendit të punës.

- Znj. E.T, me arsim dhe përvojë në fushën financiare, zotëron aftësi në administrimin e listëpagesave, përgatitjen e dokumentacionit për pagesat e ndihmës ekonomike dhe PAK, si dhe raportimin financiar.*
- Znj. A.M, me formim në shkenca sociale, zotëron aftësi në komunikim me komunitetin, trajtimin e rasteve sociale dhe ndjekjen e problematikave komunitare.*

Në këtë mënyrë, shkëmbimi i përkohshëm i pozicioneve midis dy punonjëseve u vlerësua si zgjidhja më optimale, që shërben më mirë nevojave reale të institucioneve pritëse dhe përmirëson shpërndarjen e ngarkesës së punës.

4. Objektivat e transferimit.

Ky ndryshim i përkohshëm kishte si qëllim:

- Përforcimin e përqendrimit të stafit në detyrat kryesore dhe prioritetet strategjike të njësisë;*
- Sigurimin e një qasjeje më të specializuar ndaj rasteve dhe proceseve që kërkojnë aftësi specifike sociale;*
- Optimizimin e përdorimit të kapaciteteve njerëzore, duke përputhur detyrat me ekspertizën e secilit punonjës;*
- Reduktimin e ngarkesës së tepërt në njësitë me volum pune të lartë dhe shpërndarjen më të drejtë të përgjegjësisë;*
- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe evitimin e vonësve administrative gjatë periudhës së ndryshimit.*

Transferimi ishte i përkohshëm për një periudhë deri në 6 muaj dhe është ndërprerë më herët, pas vlerësimit të ecures së procesit dhe nevojës për rishpërndarje sipas situatës reale të momentit.

5. Përputhshmëria ligjore e transferimit.

Ky vendim është marrë në zbatim të shkronjës “a” të pikës 1, shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; shkronjës “a” të pikës 2, 4, 5 të Kreut I, “Transferim i Përkohshëm”, të VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për Transferimin e Përkohshëm dhe të Përhershëm të Nëpunësve Civil”, dhe nuk ka sjellë asnjë ndryshim në kategorinë e pagës apo të drejtat financiare të ankueses.

Nga analiza e përshkrimeve të punës të dy pozicioneve, të hartuara sipas Udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017 të DAP-it, rezulton se:

- Për pozicionin Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve, kriteri arsimor është përcaktuar si “arsim i lartë në Shkenca Shoqërore, Sociale, Punë Sociale, Ekonomike, Natyrore, Juridike”.*
- Ndërkohë, në përshkrimin e punës të pozicionit Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, është parashikuar kriteri arsimor “arsim i lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike”. Kjo tregon qartësisht se arsimi dhe profili profesional i znj. E.T përputhen me kërkesat e pozicionit ku u transferua, pa asnjë element përjashtues apo diskriminues.*

6. Praktikë institucionale dhe transparenca.

Bashkia e Tiranës bën me dije se transferimet e përkohshme të punonjësve janë një praktikë e zakonshme organizative, që përdoret për të garantuar funksionimin efikas të strukturave dhe për të plotësuar nevojat të përkohshme pune në njësitë e saj. Këto lëvizje realizohen gjithmonë në përputhje me analizat e ngarkesës së punës, strukturën organizative dhe përshkrimet e pozicioneve përkatëse, pa u bazuar në vlerësime personale apo të performancës së punonjësve.

Në kërkesën tuaj të parë, nuk janë përcjellë akte shitesë, pasi çështja është trajtuar në kuadrin e rasteve identike të evidentuara në të gjitha Njësitë Administrative dhe jo brenda të gjithë strukturës së Bashkisë së Tiranës.

Siç është sqaruar më parë, transferimet e përkohshme të realizuara janë kryer gjithmonë mbi bazën e nevojave funksionale dhe organizative, duke u trajtuar secili rast në përputhje me rrethanat specifike të institucionit.

Për transparençë, gjeni bashkëlidhur listën e rasteve të tjera të transferimeve të kryera gjatë vitit 2025, e cila tregon se rasti i znj. E.T është pjesë e praktikës së përgjithshme institucionale dhe nuk përbën përjashtim.

- Shkresa nr. 19163, datë 23.05.2025, transferim i përkohshëm znj. R.Gj.*

- Shkresa nr. 20048, datë 30.05.2025, transferim i përkohshëm znj. A.D.
- Shkresa nr. 24922, datë 14.07.2025, transferim i përkohshëm znj. M.L.
- Shkresa nr. 24923, datë 14.07.2025, transferim i përkohshëm znj. R.Z.
- Shkresa nr. 32938, datë 25.09.2025, përfundim i transferimit të përkohshëm znj. R.Gj.
- Shkresa nr. 32939, datë 25.09.2025, përfundim i transferimit të përkohshëm znj. A.D.
- Shkresa nr. 37750, datë 31.10.2025, transferim i përkohshëm z. I.G.
- Shkresa nr. 37751, datë 31.10.2025, transferim i përkohshëm znj. R.K.

7. Lidhur me vlerësimin e punonjësve dhe ndërprerjen e transferimit.

Në pyetjen përse janë zgjedhur pikërisht këto dy punonjëse, duke qenë se njëra kishte vlerësim “1” dhe tjetra “3”, si dhe pse ndërprerja e transferimit u bë një ditë para seancës dëgjimore, ju sqarojmë se: Vlerësimi vjetor i performancës nuk është kriter vendimtar për transferim. Ky proces bazohet ekskluzivisht në nevojat e institucionit dhe analizën funksionale të pozicioneve të punës, me qëllim optimimin e strukturës dhe rritjen e efektivitetit të administratës vendore.

Në përmbledhje, Bashkia e Tiranës argumenton se:

- *Transferimi i përkohshëm i znj. E.T është bërë në interes të institucionit dhe në përputhje me ligjin;*
- *Është realizuar mbi kritere objektive dhe profesionale, pa element diskriminimi apo trajtimi të padrejtë;*
- *Është ndërmarrë për ribalancim të burimeve njerëzore dhe përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve;*
- *Situata tashmë është kthyer në gjendjen e mëparshme, pasi punonjësja është rikthyer në vendin e mëparshëm të punës dhe transferimi nuk ka më efekte.*

Ndërprerja e transferimit nuk ka qenë e lidhur me seancën e zhvilluar me datë 04.11.2025, por ka ndodhur për arsye funksionale dhe procedurale, pasi nevojat që e diktuan transferimin ishin ezauruar.

Periudha e transferimit është përcaktuar deri në 6 muaj, dhe ligji nuk parashikon detyrimin që ai të zgjasë plotësisht 6 muaj.

- *Shkresa për transferimin është protokolluar me datë 29.10.2025, para zhvillimit të seancës.*
- *Efektet e ndërprerjes së transferimit kanë filluar me datë 03.11.2025, ditë në të cilën ankuesja kthehej në punë nga leja vjetore.*

Pra, ndërprerja e transferimit një ditë para seancës nuk përbën asnjë ndikim ndaj vendimit të Komisionerit dhe është rezultat i planifikimit normal administrativ, duke respektuar periudhat e pushimeve të punonjësve dhe nevojat funksionale të njësisë.

Gjithashtu, ju informojmë se me shkresën nr. 2394/1, datë 04.11.2025, Njësia Administrative nr. 3, ka njoftuar fillimin e lejes së lindjes për znj. A.M. Sqarojmë se, sipas komunikimeve të herëpashershme të Njesisë së Burimeve Njerëzore, kërkesat për leje duhet të dorëzoheshin më herët, për të garantuar trajtim të rregullt dhe pa vonesa të procesit administrativ. Megjithatë, në këtë rast, kërkesa është dorëzuar vetëm një ditë para fillimit të lejes, duke mos respektuar afatin e përcaktuar.

Shkresa është protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 38081, datë 04.11.2025, dhe ka kaluar të gjitha procedurat e brendshme të institucionit përpara se të siglohej nga Drejtori i Përgjithshëm i deleguar i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm me datë 06.11.2025. Pas kësaj, është përcjellë për trajtim pranë Drejtorisë së Procedurave të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës me datë 07.11.2025. Si rrjedhojë, drejtoria ka marrë dijeni për fillimin e lejes së paralindjes dhe lejes së lindjes së znj. A.M, me datë 07.11.2025. Më tej me shkresën nr. 2444, datë 06.11.2025, protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. 20049/2, datë 06.11.2025, Njësia Bashkiake nr. 3 ka paraqitur sqarimet e saj lidhur me kërkesën për lejen e paralindjes së znj. M.

Në vijim, sjellim në vëmendje se nga momenti i fillimit të lejes së lindjes, marrëdhënia juridike dhe ajo financiare me Bashkinë Tiranë pezullohen, dhe në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pagesa për znj. A.M kryhet nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore, e jo nga Bashkia Tiranë”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike apo gjendjen arsimore, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën e saj për kushte të njëjta pune dhe page;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj gjatë marrëdhënieve të punës, që në rastin konkret është mënyra se si subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Bashkia Tiranë dhe Njësia Administrative nr. 3, kanë respektuar standardet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së ankueses.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara të parashtruara nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në të drejtën për punësim, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Me Urdhrin nr. 15725/1, datë 27.04.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, znj. E.T, ka filluar marrëdhëniet e punës, në detyrën si Specialist i Përkrahjes Sociale, Sektori i Shërbimeve Sociale, Njësia Bashkiake nr. 3, Kategoria e pagës IV-a.

Me shkresën nr. 20050, datë 30.05.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm, Drejtorisë së Procedurave të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës të Bashkisë Tiranë, ankuesja është njoftuar për transferimin e përkohshëm, nga pozicioni: Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Njësia Administrative nr. 3, kategoria e pagës IV-2, transferohet përkohësisht në interes të institucionit të Bashkisë së Tiranës, për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj në pozicionin: Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Lagje 14, kategoria e pagës IV-2, duke filluar nga data 02.06.2025.

Me shkresën nr. 20049, datë 30.05.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm, Drejtorisë së Procedurave të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës të Bashkisë Tiranë, znj. A.M është njoftuar për transferimin e përkohshëm, nga pozicioni: Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Lagje 14, kategoria e pagës IV-2, transferohet përkohësisht në interes të institucionit të Bashkisë së Tiranës, për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj në pozicionin: Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Njësia Administrative nr. 3, kategoria e pagës IV-2, duke filluar nga data 02.06.2025.

Me shkresën nr. 20050/1, datë 29.10.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm, Drejtorisë së Procedurave të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës të Bashkisë Tiranë, ankuesja është njoftuar për përfundimin e transferimit të përkohshëm, nga pozicioni: Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Lagje 14, kategoria e pagës IV-2, rikthehet në pozicionin: Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Njësia Administrative nr. 3, kategoria e pagës IV-2, duke filluar nga data 03.11.2025.

Marrëdhëniet e punës midis ankuses dhe Bashkisë Tiranë që nga periudha e emërimit në vitin 2018, e më pas kanë vijuar normalisht dhe gjatë kësaj periudhe nuk rezulton që ndaj saj të jetë marrë ndonjë masë disiplinore. Bazuar në vlerësimet e rezultateve në punë për 6-mujorin e parë të vitit 2025, rezulton se ankuesja është vlerësuar 2 (dy) “mirë”.

Ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, pasi transferimi i saj, ka ndodhur për shkak se nuk ka pranuar kërkesën e Administratores së Njesisë Administrative nr. 3, për ti dhënë listën me emra të qytetarëve që do të votonin deputeten që dëshironte dhe nuk ka pranuar të bëjë fushatë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.05.2025 dhe për shkak të gjendjes arsimore.

Marrëdhëniet juridike ndërmjet institucioneve shtetërore dhe nëpunësit civil, për rastin e transferimit të përkohshëm të punonjësve, rregullohen sipas parashikimeve të:

- Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Në nenin 48 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohet procesi i transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet se: “1. Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;

2. Transferimi mund të bëhet: a) brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale; b) në një institucion të varësisë të institucionit ku është emëruar; c) në një institucion tjetër të shërbimit civil.

3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: a) kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; b) nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

4. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm”.

Në Kreun I të VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016 përcaktohen procedurat për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësit civilë, për nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues. Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se: “2. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil: a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve”;* ndërsa në pikat 4 dhe 5 përcaktohet se: “4. *Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar apo njësisë së burimeve njerëzore. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i emëruar.*

5. Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim”.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se emërimi, transferimi dhe largimi i punonjësve, që bëjnë pjesë në strukturën e njësive administrative, është në varësi të drejtëpërdrejtë të aparatit

qendror të Bashkisë Tiranë dhe çdo riorganizim apo transferim i stafit është kompetencë e Bashkisë. Referuar dokumentacionit të dërguar nga palët, rezulton se nga ana e Njesisë Administrative nr. 3 dhe Lagjes 14, nuk ka një kërkesë me shkrim për transferimin e punonjësve.

Bashkia Tiranë ka argumentuar¹ se ky transferim është bërë për arsye se, gjatë analizës periodike të kryer nga Njësia e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Njësive Administrative, u konstatua se Njësia Bashkiake nr. 3 kishte një rritje të konsiderueshme të ngarkesës së punës për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

1. Identifikimi dhe trajtimi i rasteve komplekse sociale: Institucioni ka hasur raste të fëmijëve në rrezik dhe familjeve në nevojë për mbrojtje, të cilat kërkojnë vlerësim profesional social, vizita në terren dhe koordinim me sektorë të ndryshëm (arsim, shëndetësi, rend). Kjo nuk mund të menaxhohet vetëm nga profili financiar.
2. Vlerësimi i nivelit të rrezikut dhe hartimi i planeve individuale: Nevoja për të realizuar vlerësime të rrezikut dhe për të hartuar Planin Individual të Mbrojtjes kërkon aftësi sociale dhe njohuri për mbrojtjen e fëmijës, aftësi që tejkalojnë kompetencat financiare.
3. Koordinimi i ndërhyrjeve ndërsektoriale: Ndërhyrjet kërkojnë bashkëpunim me drejtues të njësive, strukturat shëndetësore, arsimore, policore, prokurorisë, gjyqësorit dhe shoqërinë civile. Një punonjëse me profil social është e aftë të menaxhojë këtë rrjet kompleks bashkëpunimi.
4. Monitorimi i progresit dhe raportimi: Vëzhgimi i zhvillimit të fëmijës dhe i zbatimit të masave të mbrojtjes kërkon aftësi të theksuara sociale, komunikim profesional dhe përkujdesje për nevojat e fëmijës, gjë që nuk është brenda profilit kryesor financiar.
5. Pjesëmarrja në proceset gjyqësore: Përfaqësimi i interesit të fëmijës dhe menaxhimi i rasteve në gjykata kërkon aftësi sociale dhe njohuri mbi mbrojtjen e fëmijës, të cilat nuk mbulohen nga një profil financiar.

Në mbështetje të këtij argumentimi, Bashkia Tiranë nuk dërgoi asnjë dokumentacion, të kësaj analizë periodike të bërë nga ana e saj, në 24 Njësitë Administrative dhe 3 Lagjet në administrim të saj. Në dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Tiranë, nuk rezulton asnjë transferim që të jetë kryer në nivel të njësive administrative apo lagjeve (transferimet e dërguara janë të punonjësve të Drejtorive të Bashkisë) dhe se problematika e cituar si më sipër, është identifikuar vetëm në Njësinë Administrative nr. 3. Duke pasur barrën e provës për të provuar arsyet e transferimin e përkohshëm të ankuses, Bashkia Tiranë në cilësinë e autoritetit përgjegjës, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion që të kishte bërë një analizë të shkaqeve apo vlerësim të punonjësve mbi problematikat e dala dhe në përfundim të analizës, vetëm znj. E.T ishte përzgjedhur si punonjësja që përmbushte kushtet më të mira për tu transferuar.

Referuar përshkrimit të punës të znj. E.T si Specialiste e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, rezulton se qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës është: *“Specialisti i Njesisë së*

¹ Referuar shkresës nr. 37200/1, datë 17.11.2025.

Vlerësimi të Nevojave dhe Referimit përgjigjet tek Përgjegjësi i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në NJQV, për identifikimin dhe verifikimin e rasteve të individëve të rritur në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Gjithashtu, specialisti është nëpunës civil i NJQV, i cili menaxhon rastet e individëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Ky pozicion pune është përgjegjës për identifikimin dhe verifikimin e nevojave të individëve të rritur në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Specialisti përgatit edhe dokumentacionin për individët që aplikojnë për përfitimin e shërvimeve sociale, aplikime që më pas miratohen nga këshilli i NJQV”.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar nuk rezulton se nga ana e Njesisë Administrative nr. 3 apo nga ana e Bashkisë, ti jetë kërkuar znj. E.T apo specialistes tjetër, në pozicionin si Specialiste e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe e detyrave të saj funksionale, që të kryejë vizita në terren, vlerësime sociale, koordinim ndërsektorial, monitorim dhe mbështetje e drejtpërdrejtë ndaj fëmijëve dhe familjeve. Rezulton se znj. E.T për vitet 2023, 2024 dhe 6-mujori i I-rë i vitit 2025, është vlerësuar me rezultate shumë mirë dhe mirë, në vlerësimet e punës për këtë periudhë dhe sipas deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, znj. E.T është një punonjëse shumë e mirë dhe e aftë në punë.

Referuar strukturës së Njesisë Administrative nr. 3, rezulton se Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave të Referimit përbëhet nga 4 punonjës: 1 Përgjegjës i Sektorit, 2 Specialistë të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe 1 Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve.

Ndërsa në strukturën e Lagjes 14, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave të Referimit përbëhet nga 5 punonjës: 1 Përgjegjës i Sektorit, 3 Specialistë të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe 1 Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve.

Gjithashtu, Bashkia Tiranë nuk ka argumentuar arsyen/et, se përse u përzgjedh znj. A.M, e cila ishte specialiste e mbrojtjes së fëmijëve dhe nuk u përzgjedh një nga tre specialistet e Sektorit të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave të Referimit të Lagjes 14, për tu transferuar në pozicionin si specialiste e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave të Referimit të Njesisë Administrative nr. 3.

Ankuesja ka pretenduar se transferimi i saj i përkohshëm është bërë për arsye se nuk ka pranuar që këtë vit të bëjë fushatë elektorale për kandidaten për deputete të kërkuar nga Administratorja e Njesisë Administrative nr. 3 dhe se specialistja znj. M nuk plotëson kriterin e arsimit sipas kërkesës së vendit të punës. Lidhur me këtë pretendim, rezulton se referuar përshkrimit të punës, kërkesat e posaçme për arsimin janë si më poshtë:

- Për pozicionin: Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, është parashikuar kriteri arsimor: Diplomë universitare e nivelit minimal “Bachelor” në Shkenca Ekonomike, Juridike.
- Për pozicionin: Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve, është parashikuar kriteri arsimor: Diplomë universitare të nivelit minimal “Bachelor” në Shkenca Shoqërore, Sociale, Punë Sociale, Ekonomike, Natyrore, Juridike.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se znj. E.T zotëron diplomë të nivelit Bachelor në “Financë-Bankë” dhe diplomë Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”.

Znj. A.M zotëron diplomë të nivelit Bachelor në “Shkenca politike dhe administrative me profil Shkenca politike” dhe diplomë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.

Referuar kriterit arsimor për pozicionin Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe diplomave të zotëruara nga znj. A.M, rezulton se znj. M nuk plotëson kriterin e arsimit, sipas kriterit arsimor të kërkuar në përshkrimin e punës për pozicionin Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, ndërkohë që ankuesja e plotëson kriterin e arsimit për të dy pozicionet e punës të përshkruara më sipër.

Referuar vlerësimit të punës së znj. M të bërë nga Lagjja 14, për periudhën e 6-mujorit të II-të të vitit 2024 dhe 6-mujorit të I-rë të vitit 2025, rezulton se ajo është vlerësuar respektivisht me 2 mirë dhe 3 kënaqshëm.

Referuar analizës së mësipërme, Bashkia Tiranë nuk ka shpjeguar/argumentuar se si do të realizonte objektivat² e transferimit të specialistes së Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Njesisë Administrative nr. 3, ndërkohë që specialistja e transferuar, znj. A.M nuk plotëson kriterin arsimor për këtë pozicion pune.

Në pikën 5, të Kreut I të VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016, përcaktohet se: *“Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim”.*

Bazuar në sa më sipër, rezulton se Bashkia Tiranë ka analizuar plotësimin e kriterit të arsimit të nëpunëses së transferuar, znj. E.T, e cila plotëson kriterin e arsimit, por nuk ka analizuar plotësimin e kriterit të arsimit për nëpunësen znj. A.M, e cila nuk plotëson kriterin e arsimit për tu transferuar në pozicionin e specialistes së Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Njesisë Administrative nr. 3.

² 4. Objektivat e transferimit.

Ky ndryshim i përkohshëm kishte si qëllim:

- Përforcimin e përqendrimit të stafit në detyrat kryesore dhe prioritetet strategjike të njësisë;
- Sigurimin e një qasjeje më të specializuar ndaj rasteve dhe proceseve që kërkojnë aftësi specifike sociale;
- Optimizimin e përdorimit të kapaciteteve njerëzore, duke përpunuar detyrat me ekspertizën e secilit punonjës;
- Reduktimin e ngarkesës së tepërt në njësitë me volum pune të lartë dhe shpërndarjen më të drejtë të përgjegjësi;
- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe evitimin e vonësve administrative gjatë periudhës së ndryshimit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Bashkia Tiranë, janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë, për arsye se:

- Bashkia Tiranë nuk ka bërë analizë periodike në Njësinë Administrative nr. 3 dhe në Lagjen 14, për të evidentuar faktorët dhe mangësitë në këto njësi administrative dhe si do arriheshin objektivat për përmirësimin e punës në Njësinë 3.
- Bashkia Tiranë nuk ka analizuar kriterin e posaçën të arsimit për pozicionin Specialist i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, duke transferuar znj. M, e cila nuk plotësonte kriterin e arsimit sipas parashikimeve ligjore.
- Bashkia Tiranë nuk ka parashtruar argumente/analizë se si mund të realizonte objektivat e punës znj. M në Njësinë Administrative nr. 3, ndërkohë që nuk plotësonte kriterin e arsimit dhe kishte një vlerësim pune më të ulët se znj. E.T.
- Bashkia Tiranë në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm nuk ka bërë një analizë të rezultateve të këtij transferimi, për të argumentuar realizimin e objektivave të këtij transferimi.

Për sa më sipër, Komisioneri duke mos gjetur arsye objektive dhe të ligjshme për transferimin e përkohshëm të ankueses në pozicionin e Specialistes për Mbrojtjen e Fëmijëve, në Lagjen 14, konstaton se znj. E.T është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme nga ana e Bashkisë Tiranë.

B. Shkaku i mbrojtur

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm, përbën diskriminim dhe gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas LMD.

Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”. Në lidhje me pretendimin për diskriminim në kuadër të shkakut të bindjes politike, ankuesja pretendon se, transferimi i përkohshëm i saj nga Njësia Administrative nr. 3 për në Lagjen 14, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve, ka ndodhur për shkak se nuk ka pranuar kërkesën e Administratores së Njesisë Administrative nr. 3, për ti dhënë listën me emra të qytetarëve që do të votonin deputeten që dëshironte ajo dhe nuk ka pranuar të bëjë fushatë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.05.2025. Pra, ankuesja nuk pretendon se ka pikëpamje/bindje të caktuara politike, por se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme për shkak të mospranimit për të fushatë për subjektin politik të Administratores së Njesisë Administrative nr. 3.

Në lidhje me shkakun e bindjeve politike, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: “*...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht*

ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike".

Në këtë kontekst, Komisioneri, vlerëson si shkak të njohur nga LMD si "bindje politike" edhe mospasjen e bindjeve të caktuara politike³.

Në mbështetje të pretendimit të saj, ankuesja ka depozituar foto (facebook) nëpërmjet të cilave ka identifikuar pjesëmarrjen e znj. E.T. në aktivitete politike, në pozicionin si Kryetare e Forumit të Gruas në Njësinë Administrative nr. 3, gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11.05.2025.

Komisioneri vëren se, për kuptimin e përgjithshëm të mjeteve të provave i referohet parashikimeve të nenit 80, të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, i cili kuptohet si jo kufizues lidhur me mjetet e provës për palët. Në këtë kuptim, pala mund të paraqesë para organit publik, çfarëdo lloj prove për të provuar se ka të drejtë gjatë vlerësimit të rrethanave të çështjes, përfshirë edhe fotot, të cilat janë çmuar nga Komisioneri në raport e harmoni me provat e rrethanat e tjera të çështjes.

Provat mund të jenë të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta. Në rastin e parë, provat çojnë drejt fakteve vendimtare, dhe në rastin e dytë, çojnë në fakte të cilat mund të shërbejnë si baza për arritjen e një përfundimi lidhur me një fakt vendimtar. Në këtë logjikë, rasti i dytë lidhet me pretendime që nuk faktohen vetëm me dokumenta me shkrim, por kanë të bëjnë me çdo material që është i përshtatshëm për të vërtetuar fakte apo për të konfirmuar deklarata, të tilla siç mund të jenë dhe fotografitë.

Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: "*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*".

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e palës ankuese, atë të mospasjes së "bindjeve politike", në ndryshim nga znj. T. Administratore e Njësisë Administrative nr. 3, në kohën që ankuesja i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm, i ka të ekspozuara haptazi bindjet e saj politike si përkrahëse dhe mbështetëse e fushatës së Partisë Socialiste në zgjedhjet e datës 11 Maj 2025.

- Lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të "*gjendjes arsimore*".

Lidhur me shpjegimin e ankuses tek ky shkak, ajo argumenton faktin se personi, punonjësi me të cilin krahasohet, znj. A.M, nuk plotëson kriterin e arsimit për pozicionin e punës si Specialiste e

³ Shiko: Vendimin e Komisionerit nr. 180, datë 23.09.2023 dhe nr. 99, datë 15.04.2024.

Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Komisioneri vlerëson se, nuk plotëson elementët e nevojshëm të kërkuar për përcaktimin e justifikimit të “shkakut” sipas LMD-së.

Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri⁴”*.

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që jep ankuesja lidhur me faktin se ajo plotëson kriterin e arsimit të kërkuar për pozicionin si Specialiste e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe znj. M nuk e plotëson kriterin e arsimit (pra është në shkelje të kriterit të arsimit), Komisioneri, vlerëson se, përmbushja e kriterit të arsimit është kërkesë e cila shkon në përputhje me kërkesat e këtij pozicioni pune dhe se, pasja apo posedimi i tyre nuk përbën një “shkak të mbrojtur” sipas LMD-së, në kuptimin që t’i kenë dhënë ankueses një “status” apo t’i ketë veshur asaj cilësi personale apo karakteristika të identifikueshme, të dallueshme individuale. Përmbushja e kësaj kërkesë është kriter paraprak dhe detyrim për emërimin e një punonjësi në këtë detyrë.

Komisioneri vëren se, arsyetimi i përdorur nga ankuesja lidhur me transferimin e përkohshëm të personit tjetër në pozicionin e punës si Specialiste e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, mund të lidhet me ligjshmërinë apo jo të veprimeve, apo vërtetësinë e argumenteve të dhëna nga Bashkia Tiranë, lidhur me transferimin e përkohshëm të saj, por nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të ankueses në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së⁵.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej saj.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me bindjen politike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Në praktikën e saj, Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllorja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe*

⁴ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁵ Për analogji citojmë Vendimin nr. 27, datë 23.01.2024 dhe nr. 174, datë 05.08.2025, të KMD-së.

objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se, trajtimi i diferencuar është diskriminues, nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁶.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune ndërmjet shtetit dhe një individi, që rregullohet nga dispozitat e Ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar. Në nenin 5, të ligjit sanksionohet se: *“Parimet e administrimit të shërbimit civil. Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”*.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës.

Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Ndërkohë, Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁷, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë⁸. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e

⁶ Shiko: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

⁸ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, ndër të tjera në bindjet politike të personit.

*Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*⁹ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkuqizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara, i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

*Karta Sociale Europiane*¹⁰ parashikon të drejtën për punë (neni 1) si dhe të drejtën për mbrojtje në rastet e përfundimit të punësimit (neni 24). Në vijim, në nenin E, Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindje ose statusi tjetër”. *Karta Sociale Europiane*¹¹ në nenin 1, pika 2, parashikon: “Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹².

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 82, pika 2, parashikon se: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁰ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.

¹¹ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.

¹² Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹³

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në praktikën e saj, GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹⁴”.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, ankuesja znj. E.T, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me transferimin e përkohshëm të saj, nga ana e Bashkisë Tiranë. Ankuesja ka pretenduar se vetëm nga ana e Administratores së Njesisë Administrative nr. 3, i është kërkuar për ti dhënë listën me emra të qytetarëve që do të votonin deputeten që dëshironte dhe të bëjë fushatë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.05.2025, për subjektin politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Por, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht pretendimit për ndodhjen e këtij fakti, gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës nuk u administruan fakte dhe prova për të provuar se shkak i pretenduar prej saj, ka shërbyer si shkak për të cilin ajo është diskriminuar nga ana e Bashkisë Tiranë.

Nga ana e Bashkisë Tiranë është informuar se Administratori i Njesisë Administrative nuk ka kompetencë për të bërë transferimin e përkohshëm të punonjësve dhe se kjo kompetencë është e strukturës së menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Tiranë.

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioneri ka konstatuar se Njësia Administrative nr. 3, nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me transferimin e përkohshëm të ankuses, pasi Administratorja e kësaj njësie nuk ka kompetenca për të kryer transferimin e përkohshëm, gjithashtu nuk ekziston asnjë dokument shkresor që Njësia Administrative nr. 3, të ketë bërë kërkesë për transferimin e ankuses.

¹³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁴ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë provë e drejtëpërdrejtë/tërthortë për të provuar se ankueses i është kërkuar nga Bashkia Tiranë apo Administratorja e Njesisë Administrative nr. 3, për tu përfshirë dhe për të mbështetur fushatën e Partisë Socialiste në zgjedhjet Kuvend të zhvilluara në 11 maj 2025.

Vetëm fakti se ankuesja është transferuar nga pozicioni i saj, pas përfundimit të zgjedhjeve, është i pamjaftueshëm për të ngritur dyshime se transferimi i përkohshëm i saj është bërë për këtë arsye.

Provat e administruara nuk krijojnë një nivel të tillë provueshmërie që të tregojnë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë të ankueses është shkak i mbrojtur nga diskriminimi. Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua asnjë provë që të tregonte se Bashkia Tiranë në cilësinë e autoritetit përgjegjës kishte dijeni, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, për bindjet apo mosangazhimin politik të ankueses. Në rastin konkret, është fakt i njohur se Bashkia Tiranë, është bashkia më e madhe në Shqipëri dhe ka numrin më të madh të punonjësve dhe jo detyrimisht punëdhënësi ka dijeni për bindjet politike të punonjësve.

Pra, sikundër citohet më lart, konflikti e prezumuar ankuesja e kishte me Administratoren e Njesisë Administrative nr. 3, e cila bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka kompetencë për të bërë transferimin e përkohshëm të ankueses, ndërsa theksojmë se vendimmarrës është njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Tiranë. Për rrjedhojë, konflikti mes ankueses dhe Administratores së Njesisë Administrative nr. 3, nuk mund të ketë shërbyer si shkak diskriminues, për sa kohë për transferimin e ankueses, ka vendosur një organ tjetër i cili është vendimmarrës, pra punëdhënësi i saj, Bashkia Tiranë, dhe që nuk ishte e përfshirë në këtë konflikt.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se në pamje të parë kundërshtimi i ankueses për të mos u përfshirë në fushatë, drejtuar kundër Administratores së Njesisë Administrative nr. 3, është shkak i mbrojtur nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, por referuar rrethanave, kontekstit të zhvillimit të ngjarjeve, fakteve dhe provave të sjella nga palët, vlerësohet se shkak i pretenduar nga znj. E.T, nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë me punëdhënësin/Bashkia Tiranë.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Bashkia Tiranë, nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, përbën diskriminim.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *apriori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se shpjegimi i vetëm, i arsyeshëm për transferimin e përkohshëm të ankueses, është kundërshtimi për ti dhënë listën me emra të qytetarëve që do të votonin deputeten që dëshironte Administratorja dhe të bënte fushatë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.05.2025, për subjektin politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t'u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues me pretendimin për diskriminim, për shkak të “bindjes politike”, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që Bashkia Tiranë, të ketë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, znj. E.T, nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Njesisë Administrative nr. 3, të Bashkisë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA